REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.995/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nehat Idrizi - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Lumni Sallauka, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit: R.B. nga fshati ....., Komuna Hani i Elezit, të cilin e përfaqëson F.T., avokat në Kaçanik, sipas autorizimit, kundër të paditurës: Kompania e Sigurimeve "S....." sh.a., me seli në Prishtinë, rr. "....." P...., nr. 19, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar ....., sipas autorizimit, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, C.nr.233/18 i datës 25.11.2019, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 07.06.2022, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

I. REFUZOHET pjesërisht si e pathemeltë ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës: Kompania e Sigurimeve "S....." sh.a., me seli në Prishtinë, rr. "....." P...., nr. 19, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, C.nr.233/18 i datës 25.11.2019, në pikën I, të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadisë, për kompensimin e dëmit material: për ndihmën e personit të tretë dhe për ushqimin e përforcuar si dhe në pikën II, të dispozitivit për kamatën, VERTETOHET.

II. PRANOHET pjesërisht ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës: Kompania e Sigurimeve "S....." sh.a., me seli në Prishtinë, rr. "....." P...., nr. 19, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, C.nr.233/18 i datës 25.11.2019, në pikën I, të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadisë, për kompensimin e dëmit jomaterial dhe atë: për dhimbjet fizike, frikën e përjetuar, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimin trupor dhe gjykohet si në vijim: DETYROHET e paditura: Kompania e Sigurimeve "S....." sh.a., me seli në Prishtinë, rr. "....." P...., nr. 19, që paditësit: R.B. nga fshati ....., Komuna Hani i Elezit, në emër të kompensimit të dëmit jomaterial, të pësuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 04.04.2018, ti paguaj shumat e specifikuara dhe atë: për dhimbjet fizike ti paguaj shumën prej 3.000 €, për friken e përjetuar shumën prej 2.800 €, për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 2.000 € dhe për shëmtimin trupor shumën prej 900 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë për dhimbjet fizike dhe friken e përjetuar, përtej shumës së gjykuar, REFUZOHET SI E PABAZUAR.

III. PRANOHET pjesërisht ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës: Kompania e Sigurimeve "S....." sh.a., me seli në Prishtinë, rr. "....." P...., nr. 19, NDRYSHOHET

aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, C.nr.233/18 i datës 25.11.2019, në pikën I, të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadisë, për kompensimin e dëmit material: për rehabilitim klimaterik dhe gjykohet si në vijim: REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit: R.B. nga fshati ....., Komuna Hani i Elezit, me të cilën ka kërkuar që të: DETYROHET e paditura: Kompania e Sigurimeve "S....." sh.a., me seli në Prishtinë, rr. "....." P...., nr. 19, që paditësit: R.B. nga fshati ...., Komuna Hani i Elezit, në emër të kompensimit të dëmit material të pësuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 04.04.2018, në emër të rehabilitimit klimatik, ti paguaj shumën prej 450 €, me kamatë vjetore 8 %, duke filluar prej datës 25.11.2019 (dita e aktgjykimit) e gjerë në pagesën definitive.

IV. Mbetet i pashqyrtuar dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pikën II, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë dhe në pikën III, në pjesën e kërkesës për shpenzimet e procedurës.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.233/18, i datës 25.11.2019, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që të: Miratohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit R.B. nga fshati ..... Hani i Elezit dhe Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "S....." sh.a., me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, të shkaktuar si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 04.04.2018 ti paguajë edhe atë: a. Dëmin material dhe jomaterial: për dhimbje trupore - fizike shumën prej 6.000 €, për frikën e shkaktuar shumën prej 4.200 €, për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 2.500 €, për shëmtimin trupor shumën prej 1.500 €, për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë shumën prej 900 €, për rehabilitimin klimaterik shumën prej 450 €, për ushqimin e përforcuar shumën prej 600 €, gjithsej shumen prej 16.150 €. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që të: Refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi shumat e miratuara në lartësi prej 3.300 € si e pabazuar lidhur me dhimbjet fizike dhe friken. Të gjitha këto shuma me kamatë vjetore prej 8 % duke filluar prej datës 25.11.2019 (dita e aktgjykimit) e gjerë në pagesën definitive. Në pikën III, të dispozitivit ka vendosur që të: Detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumat e gjykuara në pikën I, të këtij dispozitivi si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1.148 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata Apelit aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta prish dhe lëndën t'ia kthej të njëjtës gjykatë në rigjykim për vendosje meritore.

Me përgjigje në ankesë i autorizuari i paditësit ka propozuar që të refuzohet në tërësi si e pabazuar ankesa e të paditurës, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të mbetet në fuqi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës është pjesërisht e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 29.10.2018, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, për kompensimin e dëmit, kundër të paditurës, të precizuar si në parashtresën e datës 21.11.2019, ka kërkuar që e paditura t'ia paguaj paditësit shumat sikurse vijon: për dhimbjet fizike shumën prej 8.000€, për frikë shumën prej 5.500 €, për shëmtimin trupor shumën prej 1.500 €, për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor 2.500 €, për ushqim të përforcuar shumën prej 600 €, për ndihmën e personit të tretë shumën prej 900 € dhe për shërimin rehabilitues shumën prej 450 €, gjithsej 19.450 €, ti paguajë edhe shpenzimet procedurale, shpenzimet e eksperteve mjekësor prej 300 €, taksës për padi shumën prej 208 €, 2 seancat e përfaqësuar nga ana e avokatit prej 540 € të gjitha në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm e të gjitha këto deri në pagesën definitive me kamatë prej 8 % nga momenti i dorëzimit të kërkesëpadisë në gjykatë duke filluar nga data 29.10.2018.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të te gjitha shkresat tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.233/18, i datës 25.11.2019, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me datë 04.04.2018 rreth orës 08:40 minuta në rrugën magjistrale P..... - P....., në pompën e benzinës "....."., ky aksident është shkaktuar nga vozitësi "....." me targa ..... të cilin e drejtonte A.K., me ç' rast lëndime të rënda trupore ka pësuar paditësi R.B. nga fshati ..... - Hani i Elezit, i cili ishte duke punuar në këtë lokacion me skele, si rezultat i këtyre lëndimeve paditësi ka pësuar dhimbje fizike dhe frikë, ka pasur zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 5 %, ka pasur shëmtim në shkallë të mesme, ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë dhe ka pasur nevojë për rehabilitim klimaterik, ushqim të përforcuar dhe se përgjegjëse për mbulimin e dëmeve të tilla është e paditura, fakte këto të cilat sipas nenit 173 dhe 183 të LMD-së paraqesin bazë për kompensimin e dëmit.

Për lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket dëmit material dhe jomaterial, gjykata e shkallës së parë, në cilësinë të provës ka marr për bazë mendimin e ekspertëve mjekësor Dr. XH.S. ortoped - traumatolog dhe Dr. N.M. psikiatër, të cilët në mendimin e tyre profesional të dhënë në ekspertizën mjekësore të datës 08.10.2019, kanë konstatuar se: paditësi ka pësuar këto lëndime trupore: thyerje e hapur e gradës së I multifragmentare e femurit të djathtë dhe OP ripozicionim i hapur dhe fiksim me pllakë dhe vida, të cilat lëndime kualifikohen si lëndime të rënda trupore. Si pasojë e këtyre lëndimeve të pësuara, paditësi ka përjetuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 30 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 48 orë, të intensitetit të mesëm 42 ditë, të intensitetit të ulet janë prezentë edhe sot e kësaj dite. Si pasojë e këtij aksidenti, paditësi ka përjetuar frikë dhe atë: frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 2 ditë dhe frikë sekondare me intensitet të ulët që ka zgjatur në periudhën prej 6 muajve. Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 5 % për shkak të kufizimit të lehtë të kërdhokullës së djathtë e shoqëruar me zvogëlim të lehtë të vëllimit të masës muskulore. Shëmtimi trupor në shkallë të mesme për shkak të vrajës operatore në anën e djathtë të kofshës së

djathtë me përmasa 33x5 cm si dhe zvogëlimit të lehtë të vëllimit të masës muskulore. Ndihma e personit të tretë ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 3 muaj, ushqimi i përforcuar në kohëzgjatje prej 4 muaj. Rehabilitimi fizioterapeutik klimatik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 30 ditë për vitin e parë pas aksidentit dhe 15 ditë në vitin e dytë pas aksidentit.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 136, 159, 173 paragraf 1, 179 dhe 183 të LMD-së, lidhur me nenin 323 të LPK-së. Për kamatën gjykata ju ka referuar nenit 382 të LMD-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 449, 452 paragraf 1 dhe 453 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të padituës se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesshme të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara, gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se aksidenti i komunikacionit rrugor ka ndodhur me datë 04.04.2018, rreth orës 08:40 minuta, në rrugën magjistrale P.... - P....., përkatësisht në fshatin ....., në pompën e derivateve “.....”. Automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti ka qenë i siguruar te këtu e paditura, shkaktari kryesor i cili ka përgjegjësi ekskluzive dhe të vetme në shkaktimin e këtij aksidenti, është drejtuesi i automjetit i tipit “.....”, me targa ....., ngjyrë e ....., të cilin në momentin e aksidentit e drejtonte A.K. nga fshati ....., Komuna e Fushë Kosovës, i siguruari i këtu të padituës, këtu paditësi nuk ka përgjegjësi në shkaktimin e këtij aksidenti, si pasojë e këtij aksidenti paditësi pësON lëndime të rënda trupore. Të gjitha këto rrethana nuk janë kontestuar nga palët - këtu e paditura, gjatë shqyrtimit kryesor nuk e ka kundërshtuar bazën juridike sa i përket shkaktarit të aksidentit, siç është deklaruar përfaqësuesi i autorizuar i të padituës në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 25.11.2019, nuk e ka kundërshtuar faktin se paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore, nuk ka kontestuar se paditësi ka përjetuar dhembje fizike, frikë, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtim trupor, si pasojë e këtij aksidenti, siç kanë deklaruar ekspertët mjekësor në mendimin e tyre profesional dhe në këtë kuptim gjykata e shkallës të parë drejt ka vërtetuar gjendjen faktike për faktin se me nenin 321 paragraf 1 dhe 2 të LPK-së, përcaktohet se: “ Nuk ka nevojë të provojë faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e më hershme, gjykata nuk ka nevojë të provoj as faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor ”, në këtë rast e paditura i ka pohuar pothuajse të gjitha faktet e theksuara më lartë dhe më qëllim që kjo çështje të zgjidhet me marrëveshje, në procedurën jashtëgjyqësore i ka ofruar ofertën në

lartësi prej 5.120 €, të cilën ofertë paditësi nuk e ka pranuar. Po ashtu me nenin 180 paragraf 1 të LPK-së, përcaktohet se: “ Në ankesë nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe propozohen prova të reja përveç se kur ankuesi i jep prova se pa fajin e vetë nuk mund ti paraqes përkatësisht ti propozoj gjerë në shqyrtimin kryesor në gjykatën e shkallës së parë ”. Në këtë rast e paditura në seancën e shqyrtimit kryesor edhe pse e ka kundërshtuar lartësinë e kërkesëpadisë e njëjta me asnjë provë bindëse nuk ka argumentuar të kundërtën e pretendimeve nga padia, edhe pse ka pasur për detyrë ta bëjë një gjë të tillë në kuptim të nenit 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditësit, gjënë mbështetje në nenin 136, 140 dhe 159 paragraf 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20.12.2012.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ”, me nenin 140 të këtij ligji përcaktohet se: “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia ”, ndërsa me nenin 159 përcaktohet se: “ Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit ”.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë më rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar lidhur me pjesën e kërkesëpadisë rreth kompensimit të dëmit material: ushqimin e përforcuar dhe ndihmën e personit të tretë, për arsye se me nenin 179 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet e tjera te nevojshme lidhur më këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të pa aftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit ”. Në këtë rast paditësit i takon e drejta në kompensimin e dëmit material, për ndihmën dhe kujdesin e huaj dhe ushqimin e përforcuar, përkundër faktit se paditësi për këto kategori të dëmit nuk ka prezantuar prova konkrete materiale, kjo gjykatë vlerëson se duke i nisur nga praktika e gjertanishme e gjykatave në Kosovë, në bazë të së cilës është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve palët kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete për këtë lloji dëmi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete, gjykata ka konstatuar se në këtë rast paditësi ka pasur nevojë për ndihmë të huaj prej 3 muaj dhe ushqimi të përforcuar në kohëzgjatje 4 muaj, të njëjtit i takon ky lloji kompensimi i kërkuar në shumat e gjykuara, pasi që edhe më vetë kriteret e caktuara nga Kompanitë e Sigurimeve në Kosovë, të cilat nuk janë obliguese për gjykatat me rastin e vendosjes, por mund të merren si kritere orientuese, rezulton se të njëjtat në rastet e aksidenteve të komunikacioneve, të dëmtuarve ju njohin të drejtën në kompensimin e dëmit për ushqim të përforcuar dhe për kujdes nga personi i tretë. Ndërsa në këtë rast lartësia e kërkesës për këto kategori të dëmit është reale në raport me kohëzgjatjen për nevojën për ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë dhe ushqimin e përforcuar, duke vendosur si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar sa i përket dëmit jomaterial dhe atë: për dhimbjet fizike, frikën e përjetuar, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor

dhe shëmtimin trupor, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të nenit 195 paragrafi 1 pika e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika d) e LPK-së, sepse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për kategoritë e dëmit jomaterial dhe atë: për dhembjet fizike, frikën e përjetuar, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimin trupor, pasi që vlerësoj se shumat e gjykuara nuk ishin në përputhje me qëllimin të cilit i shërbejnë kompensimit. Në çdo rast për dëmin jomaterial, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati synimeve që synohen me kompensimin e dëmit jomaterial e që është satisfaksion për të dëmtuarin. Mbi këtë bazë Gjykata e Apelit duke e pasur parasysh natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësi, llojin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 5 %, shkallën e shëmtimit trupor - shkalla e mesme e shëmtimit si dhe rrethanat tjera si moshën e paditësit dhe praktiken e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plot me nenin 183 të LMD-së, për çka vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Aktgjykimi është ndryshuar dhe është refuzuar kërkesëpadia e paditësit sa i përket shpenzimeve për rehabilitimin klimatik, për çka Gjykata e Apelit vendosi si në pikën III, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 7 paragraf 1 e lidhur me nenin 319 paragraf 1 të LPK-së, për arsye se paditësi nuk ka ofruar prova që vërtetojnë këtë kategori të dëmit material, e që ka qenë i obliguar për një gjë të tillë, në kuptim të dispozitave të cekura me lartë.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 25.11.2019, e deri në pagesën definitive, sepse paditësi për dëmin dhe lartësinë e tij, ka ra në dijeni në momentin kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa e tij për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit.

Pika II, e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë dhe pika III, e dispozitivit për shpenzimet e procedurës nuk janë shqyrtuar sepse ankesa nuk ka qenë e drejtuar përkitazi me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë dhe pjesën e kërkesës për shpenzimet e procedurës.

Nga arsyet e paraqitura me lartë e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) dhe e), e lidhur me nenin 201 paragraf 1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.995/20, me datë 07.06.2022

Kryetari i kolegjit
Nehat Idrizi, d.v